



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës:	2024:299900
	KA.nr.624/24
Datë:	28.01.2025
Numri i dokumentit:	06780175

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ndërmarrja “Niti” SH.P.K., me NUI 810486143, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Sevdali Zejnullahu nga Prishtina, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative dhe Anulimit të Nr.Ref. 001/2024 me numër të protokollit 2168 të datës 20.09.2024, jashtë seancës, me datë 28.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit Ndërmarrja “Niti” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative dhe Anulimit të Nr.Ref. 001/2024 me numër të protokollit 2168 të datës 20.09.2024, **si e parakohshme**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrja “Niti” SH.P.K., me seli në Prishtinë ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative dhe Anulimit të Nr.Ref. 001/2024 me numër të protokollit 2168 të datës

20.09.2024, me arsyetim se nga ana e së paditurës do të duhej të ishte njoftuar me një vendim final rreth miratimit apo refuzimit të vazhdimit të licencës dhe jo me një shtyrje shtesë, sipas vendimit Nr.Ref. 001/2024 me numër të protokollit 2168 të datës 20.09.2024, i lëshuar nga e paditura KPMM.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, vërejti se në shkresat e lëndës nuk figuron kërkesa përsëritur e palës paditëse, që në aspektin juridik parashihet konform nenit 29 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se *“Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa”*.

Andaj gjykata konsideron se në mungesë të kërkesës së përsëritur nga pala paditëse nuk plotësohet kushtet që me padi të iniciohet konflikt administrativ për shkak të heshtjes administrative. Prandaj në rastin konkret padia konsiderohet e parakohshme sepse nuk ka prova që vërteton se paditësi i ka shterur të gjitha mjetet e brendshme juridike, për të hapur konfliktin administrativ në gjykatë sipas nenit 29 par.1 të LKA-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 34 par.1 të LKA-së në të cilin parashihet se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme”*, vendosi si në diapozitivin të këtij Aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale si në diapozitivin II të këtij Aktvendimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.624/24, datë 28.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.